


-Teh info. P.m
26.11.2020
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE



Nr. 119/765 Akti

Korce ne date 23.11.2020

“NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE ”

(Per njoftimin e cilesise procedurale dhe seances gjyqesore)

Drejtuar per afishim: Ne kendin e njoftimeve te Bashkise Maliq

Per shtetasin/shtetasen: Zinie Bazelli pale e paditur ne gjykim.

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe eshte duke u gjykuar ne faze te dyte te pjestimit, çeshtja civile qe i'u perket paleve:

PADITES: Kamber Bazelli

TE PADITUR: Vasil (Sali) Bazelli, Ferdinand Bazelli, Viollanda Guri (Bazelli), Stoli Bazelli (Bylo), Flutura Vasha dhe Gani Bazelli.

OBJEKTI: Pjestim pasurie nr.18/194, zona kadastrale 3553, vol 9, faqe 115, me sipërfaqe 2560 m², ndodhur ne Symiz

BAZA LIGJORE: Nenet 370 e vijues te K.Pr.Civile.

Gjate gjykimit te padise, ne faze te dyte te pjestimit, rezulton se ka nderruar jete shtetasi Gani Bazelli, dhe trashëgimtare te tij rezultojne shtetasit Zinie Bazelli (e shoqja) dhe femijet: Aleksander Bazelli, Dhimiter Bazelli dhe Etleva Matraku.

Sipas nenit 199 parag 1 te K.Pr.Civile kur njera nga palet vdes, çeshtja vazhdon nga ose kunder trashëgimtareve te tij.

Sa me sipër, duke realizuar kalimin procedural, te drejtat dhe detyrimet e te paditurit Gani Bazelli kalojne tek trashëgimtares e tij te cilet marrin ne gjykim cilesine e pales se paditur.

Rezultoi se Juve si e paditur nuk ndodheshit ne vendbanimin zyrtar dhe per rrjedhim Gjykata vendosi te procedoje me njoftimin nepermjet shpalljes publike, bazuar ne nenet 133/a dhe 133/b, te K.Pr.Civile, duke u afishur nje kopje e shpalljes prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe, si gjykata ku gjykohet mosmarreshja, nje kopje prane Bashkise Maliq, ku ndodhet vendbanimi Juaj, nje kopje ne deren e baneses Tuaj dhe ne faqen zyrtare te gjykates.

Nepermjet ketij njoftimi Ju bejme me dije se jeni thirrur ne cilesine e te paditures ne kete proces gjyqesor dhe seanca gjyqesore pasardhese eshte planifikuar te zhvillohet ne date 21.12.2020, ora 9.00, ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korçe. Mosprezenca Tuaj pa shkak te perligjur per te justifikuar mungesen, passjell zhvillimin e gjykimit ne mungesen Tuaj.

Kjo shpallje do te qendroje e afishuar ne vendet e mesiperme minimalisht 20 (njetzet) dite nga dita e neserme e afishimit.

GJYQTARE
SONJELA VOSKOPI



Nr. 141 Prot

21.12.2020

[Signature]